



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. 42 Prot.

Kopje Nr. 24/2/
Tiranë, më 24/2/2022

U D H Ë Z I M

Nr. 42, datë 24. 2. 2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E PROCESIT DHE PROCEDURAVE TË HARTIMIT,
PËRDITËSIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË LISTËS SË MIRATUAR TË
PRODUKTEVE TË SIGURISË SË INFORMACIONIT “SEKRET SHTETËROR”
(LPMSI)**

Në mbështetje të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 542, datë 25.7.2019, “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI)”, me qëllim:

1. Përcaktimin e një liste produktesh të sigurisë së informacionit “sekret shtetëror” të miratuara për përdorim për institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë (Lista e Produkteve të Miratuara të Sigurisë së Informacionit (LPMSI)).
2. Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të DSIK dhe institucioneve shtetërore për përdorimin e Listës së Produkteve të Miratuara të Sigurisë së Informacionit (LPMSI) si dhe listave të produkteve të sigurisë të miratuara nga NATO dhe BE, në funksion të rritjes së sigurisë së sistemeve që trajtojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

U D H Ë Z O J:

I. Të përgjithshme

3. Institucionet shtetërore, për nevoja të punës së tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së sistemeve që duan të implementojnë, të përdorin produkte të sigurisë së informacionit të vlerësuara sipas një liste të njohur sipas standarteve kombëtare, të NATO dhe ose BE.
4. Produkti i sigurisë së informacionit është çdo produkt që përmban një ose disa

funksiione sigurie që kërkohet të implementohen në përputhje me kërkesat e sigurisë së SKI.

5. LPMSI është Lista e Produkteve të Miratuara të Sigurisë së Informacionit, e cila përmban listën e produkteve të sigurisë së informacionit miratuar për përdorim nga institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë.
6. Ky udhëzim shërben për:
 - a. Hartimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e LPMSI.
 - b. Përdorimin e LMPSI, katalogut të produkteve të sigurisë së informacionit të NATO (NIAPC) dhe listave të produkteve kriptografike të aprovuara dhe kompanive TEMPEST të akredituara të BE.
 - c. Përcaktimin e kërkesave të sigurisë dhe procedurave për përdorimin e produkteve të sigurisë jashtë listave të mësipërme.

II. Ndarja e Roleve dhe Përgjegjësi

7. Drejtoria e Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit në DSIK është përgjegjëse për të siguruar implementimin e këtij udhëzimi nga institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë që trajtojnë informacion të klasifikuar në SKI dhe kërkojnë të përdorin produkte sigurie për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror".
8. Drejtoria e Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit në DSIK është përgjegjëse për hartimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e LMPSI.
9. Drejtoria e Shifrës pranë Ministrisë së Mbrojtjes (AKSK) është përgjegjëse për vlerësimin e sistemeve, produkteve dhe mekanizmave kriptografikë dhe përcjelljen e Akt vlerësimi përkatës pranë DSIK, kur kërkohet.
10. Institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat e sigurisë në përputhje me legjislacionin për sigurinë e informacionit të klasifikuar dhe të përdorin produkte sigurie për mbrojtjen e informacionit që përpunohet, ruhet ose transmetohet (administrohet) në sistemet e komunikimit dhe informacionit.
11. Punonjësit e institucioneve shtetërore që përfshihen në planifikimin, përzgjedhjen dhe prokurimin e sistemeve/pajisjeve të kenë akses në LPMSI.

III. Hartimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e LPMSI

12. Gjatë hartimit të Konceptit të Operimit (KO) të sistemit, institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë në një ndarje të veçantë përshkruan sistemin dhe arkitekturën e sigurisë së sistemit. Gjithashtu, përcakton funksionet dhe karakteristikat e sistemit dhe kërkesat specifike për implementimin e tyre, të ndara në kërkesa funksionale dhe kërkesa të garantimit të sigurisë (garantimit të përmbushjes së kërkesave funksionale).
13. Kërkesat funksionale përcaktojnë aspektet e sigurisë që kërkohet të përmbushen (mënyrën e reagimit të sigurt të sistemit për rrethana të caktuara), ndërsa aspektet e garantimit të sigurisë përbëjnë bazën për formimin e besimit që masat e kërkuara janë efektive dhe të implementuara saktë.

14. Rregullorja për Sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe të Informacionit (SKI) përcakton kërkesën për përdorimin e produkteve të vlerësuara sipas standarteve kombëtare, NATO dhe/ose BE.
15. Gjatë hartimit të KO, dhe më tej gjatë projektimit, prokurimit dhe implementimit të sistemit, LPMSI, listat e NATO dhe BE të jenë rruga parësore për përzgjedhjen e produkteve të sigurisë për përdorim në sistemet që trajtojnë informacion të klasifikuar.
16. Kërkesat për produkte të vlerësuara sipas listave të përshkruara në këtë udhëzim të jenë pjesë e DT të projekteve të klasifikuara. Për secilin produkt të kërkuar sipas këtyre listave, kontraktori të ofrojë evidencat përkatëse të vlerësimit si dhe statusin e vlerësimit/certifikimit (nivelit).
17. Nëse produktet e kërkuara nuk janë në ndonjë prej listave të miratuara më lart, institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë përzgjedhin produkte të vlerësuara sipas një standarti të mirënjohur ndërkombëtar për funksionin e sigurisë që do të implementojë me kusht që të kryejë vlerësimin e riskut të sigurisë së produktit që kërkon dhe ta dokumentojë atë.
18. Ky vlerësim, i shoqëruar me dokumenta të tjera mbështetëse, nëse ka, përfshirë raporte vlerësimi apo certifikata sipas standarteve të mirënjohura ndërkombëtare, i dërgohet DSIK për miratim.
19. DSIK, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë vlerësim nga autoritetet e tjera të sigurisë.
20. Nëse produkti miratohet për përdorim, përditësohet LPMSI së bashku me kushtet e përdorimit të produktit, nëse ka, dhe kjo i konfirmohet institucionit shtetëror që bëri kërkesën.
21. Nëse produkti nuk miratohet për përdorim, institucionit shtetëror dhe Operatorit Ekonomikë i konfirmohet mosmiratimi për përfshirje të produktit në LPMSI.
22. LPMSI përditësohet me sisteme, produkte, mekanizma, algoritma dhe/ose protokolle kriptografikë, me kusht që këto sisteme, produkte, mekanizma, algoritma dhe/ose protokolle kriptografikë të vlerësohen paraprakisht nga Drejtoria e Shifrës (AKSK) dhe miratohen më pas nga DSIK (AKAS).

IV. Kategoritë e LPMSI

23. LPMSI duhet të përmbajë Produkte të kategorive të përcaktuara në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
24. Produktet e përfshira në LPMSI janë të tipeve: Produkte dhe mekanizma kriptografikë ose produkte të sigurisë së informacionit.
25. Drejtoria e Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit harton, përditëson dhe mirëmban LPMSI me këto të dhëna minimale:

- a. Nr. Identifikimi i produktit
 - b. Emri i produktit
 - c. Kategoria e produktit
 - d. Prodhuesi
 - e. Vendi i origjinës
 - f. Përshkrim i shkurtër i produktit
 - g. Niveli i klasifikimit, nëse aplikohet
 - h. Imazhe të produktit, nëse ka
 - i. Dokumenta shoqëruese të produktit, nëse ka
 - j. Komente shtesë, nëse ka
 - k. Kushtet e përdorimit, nëse ka
26. DSIK publikon LPMSI në website zyrtar të DSIK.
27. LPMSI mund të aksesohet në website: www.nsa.gov.al në rubrikën LPMSI.
28. Lista publikohet në format pdf, ku produktet janë të ndara sipas kategorive dhe informacioni minimal i përfshirë në listë janë pikat a, b, c, d dhe e.
29. Për informacione të miratuara në një nivel të caktuar klasifikimi, përfshihet edhe pika g.
30. Lista e produkteve të miratuara të NATO mund të aksesohet në website: www.ia.nato.int/niapc/.
31. Listat e produkteve kriptografike dhe kompanive TEMPEST të akredituara të BE mund të aksesohen në website: www.consilium.europa.eu/en/general-secretariat/corporate-policies/classified-information/information-assurance/
32. Për informacione më të detajuara institucionet shtetërore kontaktojnë DSIK.

V. Siguria e emetimeve – lista e kompanive TEMPEST të miratuara

33. Institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomikë, për nevoja të punës së tyre, mund të kërkojnë të përdorin produkte TEMPEST.
34. NATO dhe BE kanë përfshirë në listat e tyre kompani TEMPEST të akredituara në përputhje me SDIP 55 të NATO ose IASG 7-04 të BE. Këto kompani janë akredituar nga NATO ose BE për shitjen e produkteve të tempestuara, produkteve për kryerje të matjeve TEMPEST të zonave të sigurisë etj.

Aneksi 1 - LPMSI

LPMSI duhet të përmbajë Produkte të kategorive si më poshtë:

a. Produkte dhe mekanizma kriptografikë

- i. Autoritet Certifikues (CA - Certificate Authority)
- ii. Kriptim komunikimesh
- iii. Kriptim disku/dokumentash
- iv. Nënshkrim dhe kriptim email
- v. Kriptim i IP
- vi. Menaxhim çelësash
- vii. PKI (Infrastruktura e çelësave publikë)
- viii. VPN (Rrjet virtual privat)
- ix. Tjetër

b. Produktet e sigurisë së informacionit

- i. Kontroll Aksesit
- ii. Kontroll dhe Konfigurim i Aplikacioneve
- iii. Menaxhim Asetesh
- iv. Software Auditimi
- v. Autentifikim
- vi. Sisteme Operimi
- vii. Menaxhim Patch-esh
- viii. Siguri Fizike
- ix. Menaxhim Rekordesh
- x. Vlerësim Risku
- xi. Smart Cards
- xii. Biometrics
- xiii. Kontroll/filtrim Përmbajtje
- xiv. Menaxhim Disku
- xv. Menaxhim Dokumentesh
- xvi. Përforcues i Politikave Email
- xvii. Firewall
- xviii. Menaxhim Identiteti
- xix. Information Rights Management (IRM)
- xx. IT Health Check
- xxi. Mbrojtje Malware

- xxii. Menaxhim Rrjeti
- xxiii. Fshirje Disku
- xxiv. Computer Forensics
- xxv. Intrusion Detection and Prevention
- xxvi. Diodë të dhënash

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Dorian TOLA



Dorian Tola